



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. 837 prot.

Tiranë, më 27.03 .2024

NJOFTIM ME SHPALLJE

TË VENDIMIT NR. 1163/9, DATË 25.10.2023 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, “PËR ARKIVIMIN PAS VERIFIKIMIT TË ANKESAVE TË BASHKUARA TË PARAQITURA NGA SHTETASJA ZNJ. FIQRETE RRAPAJ”

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesat e bashkuara të znj. Fiqrete Rrapaj me nr. 1034 prot., datë 10.06.2020, me nr. 326 prot., datë 26.02.2020 dhe me nr. 1034/2 prot., datë 27.07.2020 në të cilat ngrihen pretendime ndaj magjistratëve S. D me detyrë gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe E.M, B.SH, B.H dhe A.D, me detyrë gjyqtarë pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë në kohën e kryerjes së shkeljes së pretenduar dhe me vendimin nr. 1163/9, datë 25.10.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për arkivimin pas verifikimit të ankesave të bashkuara të paraqitura nga shtetasja znj. Fiqrete Rrapaj”, bazuar në nenin 122, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendimi duhet t’i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Vlorë, sipas adresës së lënë nga ankuesi; Rruga “Pelivan Leskaj”, nr. 6 Vlorë;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al.

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM



Konceptoi: Z. Feçi
Pranoi/Miratoi: E.Kuçi
2 (dy) kopje, datë 26.03.2024